



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenit 37.2 nen paragrafi (c) i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenin 5 paragrafi 1.3, neni 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 02.10.2019, nxjerr këtë:



V E N D I M

- I. **ZNJ. FERDANE BEQIRI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Skenderaj nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës- PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Fitore Mangjolli.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Ferdane Beqiri dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 01.10.2019, Nr.1316/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal znj. Fitore Mangjolli, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, znj. Ferdane Beqiri nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 02.10.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka